

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”



PLANI STRATEGJIK 2023-2025

Prishtinë, Korrik 2023

PËRMBATJA

- 1. Përmbledhje ekzekutive**
- 2. Hyrje**
- 3. Metodologjia**
- 4. Analizë e gjendjes aktuale**
- 5. Objektivat strategjikë**
- 6. Zbatimi, monitorimi dhe raportimi**
- 7. Ndikimi buxhetor i strategjisë**

SHKURTESAT

BE	Bashkimi Evropian
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar)
KQSC	Komisioni Qendror për Sigurimin e Cilësisë
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MM	Memorandum Mirëkuptimi
NJA	Njësitë Akadematike
PA	Parlamenti Studentor
QPM	Qendra për Përsosmëri në Mësimdhënie
QUGJ	Qendra Universitare për Gjuhë
QZHK	Qendra për Zhvillimin e Karrierës
SHU	Shoqatat e Universitetit
TI	Teknologjia e Informacionit
UP	Universiteti i Prishtinës
USAID	Ndihma e ShBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar
ZMJ	Zyra për Marrëdhënie me Jashtë
ZKPS	Zyra për Kërkime dhe Projekte të Sponsorizuara
ZZHC	Zyra për Zhvillim të Cilësisë

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Universiteti i Prishtinës, në harmoni me Planin Strategjik të Arsimit të Lartë të Kosovës 2022-2026, ka identifikuar një numër të objektivave strategjike, me qëllim që të avancojë pozitën konkurruese në ofrimin e shërbimeve cilësore për nevojat e popullsisë së Kosovës dhe më gjerë. Për të arritur këtë qëllim, janë identifikuar prioritetet e tyre, duke u bazuar në kapacitetet dhe resurset njerëzore, financiare dhe logjistike, në mënyrë që të zhvillohen dhe udhëhiqen drejt përmbushjes së objektivave strategjike. Prioritetet janë si në vijim:

Ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie me qëllim të zhvillimit të kompetencave të studentëve, përmes rishikimit të programeve të studimit, avancimit të infrastrukturës akademike, rritjes së angazhimit të studentëve, nxitjes së përsosmërisë në mësimdhënie dhe kërkim dhe zbatim të standardeve të larta të vlerësimit institucional dhe të programeve të studimit.

Avancimi i shkencës, inovacioni dhe ndërlidhja më e mirë me tregun e punës përmes harmonizimit të programeve të studimit, rritjes së mundësive për punë praktike të studentëve, bashkëpunimit me ndërmarrje dhe rritjes së programeve ndërdisiplinare dhe programeve STEM.

Përmirësimi i pozicionit dhe roli i UP-së në skenën ndërkombëtare përmes programeve të përbashkëta të studimit, rritjes së pjesëmarrjes në programe ndërkombëtare të bashkëpunimit akademik dhe shkencor, si dhe integritimit në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.

Avancimi i infrastrukturës dhe përdorimi i teknologjisë digjitale për përmirësimin e shërbimeve dhe të cilësisë në arsim, në përputhje me trendet e transformimit digjital.

Fuqizimi i qeverisjes, integritetit dhe financimit përmes rishikimit të legjislacionit, zhvillimit të sistemit të avancuar të menaxhimit të informatave, rritjes së kapaciteteve profesionale, përmirësimit të shërbimeve për studentë dhe sigurimit të integritetit akademik, transparencës dhe llogaridhënies në arsimin e lartë.

2. HYRJE

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” është institucion publik, më i madhi në vend në ofrimin e arsimit të lartë, ndërkohë që përfshin nën vete 14 njësi akademike. Qëllimi i UP-së ka qenë promovimi i jetës akademike dhe intelektuale dhe i ndryshimeve politike, ekonomike dhe shoqërore në përparim të vendit dhe shoqërisë kosovare. UP-ja mban përgjegjësinë shtetërore dhe qytetare në edukimin e të rinjve të Kosovës për t'u përgatitur si qytetarë të denjë dhe të dobishëm për nevojat e vendit.

UP-ja i ka mbijetuar kohës dhe ka qenë lider në ofrimin e nxënies dhe zhvillimin e kuadrove të reja. Megjithatë, UP-ja përballet me sfida të mëdha për të përmbushur kërkesat e studentëve dhe shoqërisë në përgjithësi, për të mbajtur hapin dhe për të plotësuar nevojat e ekonomisë kosovare. UP-ja ka punuar pa ndërprerje për të forcuar dhe zgjeruar institucionin, duke ndjekur trendet e arsimit të lartë në Evropë dhe SHBA. UP-ja ka marrë seriozisht nevojën për ndryshime, si rrjedhojë e kërkesave të tregut të punës në Kosovë, dhe është duke u mobilizuar dhe organizuar për adresimin e këtyre sfidave në mënyrën më të mirë të mundshme.

UP-ja, si pasojë e situatës aktuale dhe kërkesave të tregut të punës në Kosovë, ka punuar në Planin Strategjik për të adresuar sfidat dhe nevojat aktuale. Pas identifikimit të tyre, në bashkëpunim me Këshillin Drejtues dhe rektorin, është krijuar dokumenti "Plani Strategjik i UP-së 2023-2025", që synon të përmirësojë cilësinë e të gjitha shërbimeve të UP-së. Për të organizuar dhe implementuar aktivitetet e planifikuara në mënyrë sa më efektive, grupi punues ka ndarë këto aktivitete dhe nevoja në pesë shtylla kryesore, të cilat janë prezantuar në dokument.

3. METODOLOGJIA E PËRPILIMIT TË STRATEGJISË

Në mbledhjen e Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës, më 15.03.2023, u formua një komision për hartimin e Strategjisë së UP-së, bazuar në vendimin nr. 610 të datës 15.03.2023 dhe nenin 22 të Statutit të UP-së. Kjo strategji do të udhëheqë të gjitha aktivitetet zhvillimore të UP-së dhe do të përdoret si tregues i performancës së strukturave menaxhuese të universitetit.

Komisioni punues për hartimin e Strategjisë së UP-së përbëhet nga 9 anëtarë, prof. dr. Arta Basha-Jakupi, në cilësinë e kryesueses së komisionit, dhe anëtarët Arta Shehu-Zajmi, prof. ass. dr. Luljeta Plakolli-Kasumi, prof. dr. Naser Kabashi, prof. asoc. dr. Dashamir Berxulli, prof. asoc. dr. Afrim Xhela, prof. ass. dr. Genc Reznqi, msc. Besfort Krasniqi dhe Nehat Drevishi. Komisioni ka bërë një përgatitje fillestare, duke kompletuar dokumentacionin relevant për hartimin e Planit Strategjik të UP-së, duke përfshirë dokumentet strategjike të MASHT-it për arsimin e lartë, dokumentet sektoriale strategjike të UP-së dhe dokumentet ndërkombëtare të arsimit të lartë.

Përgatitja e dokumentit ka ndjekur një dinamikë të miratuar nga Këshilli Drejtues, duke përfshirë fazat e draftimit të dokumentit nga Komisioni i KD-së, finalizimin e dokumentit për diskutim publik me zyrat menaxheriale, njësitë akademike, studentët, donatorët dhe partnerët, para se të aprovohet nga Këshilli Drejtues.

Grupi punues ka mbajtur shtatë takime pune dhe konsultative për të përcaktuar prioritetet dhe për të hartuar një draft fillestar të dokumentit. Ky draft është dërguar për kontributet shtesë nga njësitë akademike dhe zyrat relevante të UP-së.

Pas kësaj faze, draft-dokumenti, përmes dekanëve, është dërguar për diskutim publik me stafin akademik brenda datave 25.05 - 31.05.2023. Këshilli Drejtues falënderon të gjithë ata që kanë kontribuar në hartimin e Planit Strategjik të UP-së 2023-2025 në çfarëdo forme.

4. ANALIZË E GJENDJES AKTUALE

Veprimtaria e Universitetit të Prishtinës është e bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin dhe rregulloret përkatëse të Këshillit Drejtues dhe të Senatit. Raportet vjetore të punës vërtetojnë se UP-ja ka arritur të ndjekë dhe të realizojë objektivat kryesorë strategjike në mënyrë të suksesshme. Ky sukses i ndërlikuar mund t'i atribuohet përkushtimit dhe angazhimit të strukturave menaxhuese, stafit dhe studentëve të UP-së. Në të gjitha fushat kryesore strategjike të veprimtarisë së UP-së, ka shënuar rezultate të rëndësishme, që tregojnë se ky institucion ka arritur të bëhet më i pjekur në aspektin institucional dhe organizativ dhe mundëson realizimin e misionit të tij në aspektin kadrovik, hulumtues dhe kontribuues në shoqëri.

Në kontekstin e zhvillimeve pozitive në vitin 2022, si vit bazë për vlerësimin e ndikimit të Strategjisë 2023-2025, duhet të theksohet që UP-ja ka arritur të zhvillojë më tutje strukturat ndërvepruese ndërmjet programeve akademike dhe aktorëve të tregut të punës si dhe është në proces të ndërtimit të skemave, të cilat mundësojnë që gjetjet nga ndërveprimi i tillë të reflektohen në programet akademike dhe në këtë mënyrë në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së studimeve. Po ashtu, është vazhduar me ngritjen profesionale të personelit akademik dhe ngritjes së cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet ofrimit të vazhdueshëm të trajnimeve, të cilat janë të fokusuara në mbështetjen e mësimdhënësve nëpërmjet demonstrimit të praktikave më të mira, respektivisht në aplikimin e metodave kreative dhe aktivizuese karakteristike për mësimdhënien moderne.

Me qëllim të sigurimit të përtëritjes kadrovike dhe ofrimit të mundësive për gjeneratat e reja me përgatitje adekuate, UP-ja ka realizuar me sukses konkursin publik, nëpërmjet të cilit janë punësuar një numër i konsiderueshëm i asistentëve dhe profesorëve të rinj, të cilët pritet të sjellin një dinamikë të re në procesin mësimor dhe veprimtarinë kërkimore-shkencore në vitet që pasojnë. Rezultate impulsive janë shënuar edhe në fushën e kërkimit shkencor, ku është shënuar një rritje domethënëse e publikimeve shkencore në revista kredibile shkencore.

Po ashtu në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar janë shënuar rezultate domethënëse, duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me universitete dhe institucione ndërkombëtare dhe vendore, duke arritur në këtë mënyrë jo vetëm ruajtjen dhe kultivimin e raporteve me partnerët, por në disa aspekte avancimin dhe konkretizimin e tyre. Rezultate konkrete janë shënuar edhe në aspektin e përmirësimit dhe zgjerimit të infrastrukturës akademike dhe laboratorike të UP-së, nëpërmjet renovimeve në disa njësi akademike dhe inicimin e ndërtimeve të reja, bazuar në nevojat e identifikuara.

Gjatë vitit 2022, zhvillime pozitive ka pasur edhe në drejtim të rritjes së disiplinës financiare, kontrollit dhe përgjegjësisë financiare. Në këtë fushë është shënuar po ashtu një rritje në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale, por edhe në kategorinë e granteve nga donatorët, të cilat janë reflektuar pozitivisht në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Në funksion të rritjes së kontrollit dhe duke pasur parasysh gjetjet e auditorit të brendshëm dhe atij të jashtëm, UP-ja ka marrë veprime konkrete, që shumë prej atyre gjetjeve të adresohen në tërësi e për disa tjera janë ndërmarrë veprime, të cilat pritet që do të kontribuojnë në zvogëlimin e gjetjeve të auditorëve në të ardhmen.

Përkundër progresit të shënuar në të gjitha fushat relevante të veprimtarisë së UP-së, të prezantuara në raport, ky institucion vazhdon të ballafaqohet me sfida të natyrave të ndryshme. Një ndër sfidat më kryesore, me të cilat është ballafaquar UP-ja në vitin 2022 dhe e cila pritet të vazhdojë edhe në të ardhmen, është ruajtja e akreditimit të programeve ekzistuese akademike dhe zhvillimi i programeve të reja në kontekstin e standardeve të reja të akreditimit.

Sfidat tjera të identifikuara janë realizimi i konkurseve për personel akademik në periudha të rregullta kohore, duke ruajtur standardin tashmë të krijuar, përmirësimi i shërbimeve administrative dhe rritja e efikasitetit të këtij shërbimi nëpërmjet realizimit të konkurseve për personel administrativ dhe plotësimi i pozitave të lira me individ të përzgjedhur me procedura transparente, ngritja e mekanizmave të monitorimit dhe kontrollit të të gjitha instancave institucionale, niveli i lartë i detyrimeve kontingjente, për shkak të obligimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive SBASHK-MASHT, pamundësia e zgjerimit të hapësirave të universitetit, për shkak të mungesës së lokacionit, realizimi me vështirësi i projekteve kapitale, për shkak të procedurave të prokurimit, rritja e transparencës në punë,

funksionalizimi i mekanizmit llogaridhënës, pamundësia e adresimit të plotë të gjetjeve të auditorit në rastet kur të njëjtat varen jo vetëm nga UP-ja, por edhe nga instancat tjera, digjitalizimi më i shpejtë i shërbimeve që ofrohen, krijimi i mekanizmave të rinj dhe zhvillimi i mëtejshëm i atyre ekzistues për nxitjen e veprimtarisë kërkimore-shkencore, eliminimi i pengesave për ndërkombëtarizimin më të gjerë të UP-së, planifikimi më i mirë i investimeve kapitale lidhur me përmirësimin e infrastrukturës laboratorike dhe zgjerimin e saj si dhe ndërtimi i hapësirave të reja për nevoja akademike dhe për nevoja të shërbimeve, të cilat UP-ja mund t'i ofrojë për palët e treta. Një sfidë tjetër paraqet edhe zgjerimi i shërbimeve, të cilat UP-ja i ofron për komunitetin dhe përfshirja më aktive e UP-së në të gjitha zhvillimet relevante të shoqërisë, në të cilat ka mundësi të kontribuojë me potencialin e vet akademik, shkencor e profesional.

5. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS

Ky plan strategjik ka pesë objektiva strategjike që janë ndarë në nga pesë objektiva specifike, të segmentuar më tutje në aktivitete të implementimit, të cilat përfshijnë treguesit për matjen e arritjes së objektivit, afatet kohore, stafin përgjegjës dhe burimet e nevojshme për t'i realizuar. Renditja e këtyre objektivave specifike ofron fusha me fokus për tre vjetët e ardhshëm në UP. Lista e prioriteteve është një përmbledhje e fushave me fokus institucional që duhet të konsiderohen, por progresi dhe fokusi duhet të rishikohen rregullisht, së paku një herë në vit, duke u bazuar në indikatorë dhe në një proces periodik formal të rishikimit dhe rivlerësimit të planit. Objektivat specifike të renditur janë hartuar me qëllim që secili të jetë i veçantë dhe të mos përsëritet, por disa mund të duken si të përsëritur apo të ngjashëm në një plan organizativ të tillë kompleks.

OBJEKTIVI I STRATEGJIK 1	Ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie
OBJEKTIVI I STRATEGJIK 2	Avancimi i shkencës, inovacionit dhe ndërlidhja me tregun e punës
OBJEKTIVI I STRATEGJIK 3	Përmirësimi i pozicionit dhe rolit të UP-së në skenën ndërkombëtare
OBJEKTIVI I STRATEGJIK 4	Digjitalizimi dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike
OBJEKTIVI I STRATEGJIK 5	Fuqizimi i qeverisjes, integritetit dhe financimit

Universiteti i Prishtinës ka përcaktuar treguesit për matjen e arritjes së objektivave strategjike dhe cakun e synuar më 2025. Arritja e objektivave strategjike do të rezultojë me rezultate më të larta të studentëve, rritje të numrit të studentëve dhe rritje të numrit të të diplomuarve; rritje të cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie; përmirësim të pozitës së UP-së në arenën ndërkombëtare; digjitalizim të shërbimeve administrative dhe të mësimdhënies; përmirësim të infrastrukturës së punës si dhe fuqizim të qeverisjes dhe menaxhimit financiar.

Objektivat strategjike janë prezantuar në formë tabelare për të lehtësuar leximin dhe ekzekutimin e tyre. Njësitë administrative dhe akademike të Universitetit të Prishtinës pritet të hartojnë plane për zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve brenda tyre. Plani i Veprimit, i cili do t'i bashkëngjitet Planit Strategjik, do të vazhdojë të përmirësohet me kontributet nga palët e interesuara brenda dhe jashtë

universitetit, në mënyrë që të jetë sa më konkret në ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për arritjen e objektivave strategjikë dhe objektivave specifikë. Plani i Veprimit po ashtu përmban edhe koston e përafërt financiare të secilit veprim.

Objektivi strategjik 1: Ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie

Me qëllim të rritjes së cilësisë në mësimdhënie dhe në mësimnxënie, kjo strategji parasheh disa objektiva specifikë, sikurse inkurajimi i ekselencës në mësimdhënie përmes aplikimit të metodave të reja; rishikimi dhe avancimi i programeve të studimit; zbatimi i standardeve të larta për vlerësimin institucional si dhe vlerësimin e programeve; rritja e përfshirjes dhe angazhimit të studentëve dhe rritja e performancës akademike.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1	Ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie
Objektivi specifik	1.1. Inkurajimi i ekselencës në mësimdhënie me metoda të reja
Objektivi specifik	1.2. Rishikimi dhe avancimi i programeve të studimit
Objektivi specifik	1.3. Zbatimi i standardeve të larta të vlerësimit institucional dhe programeve të studimit
Objektivi specifik	1.4. Rritja e përfshirjes dhe angazhimit të studentëve
Objektivi specifik	1.5. Rritja e performancës akademike

Objektivi specifik 1.1. Inkurajimi i ekselencës në mësimdhënie me metoda të reja

Për të matur rritjen e ekselencës në mësimdhënie, do të përdorën tregues të qartë sikurse niveli i rritjes së numrit të të diplomuarve, rritja e pjesëmarrjes së studentëve në vlerësime të metodave të mësimdhënies, shtimi i kualifikimeve të stafit akademik, trajnimet e vazhdueshme të stafit akademik, zhvillimi i resurseve të brendshme për të ofruar trajnime mbi metodat e reja të mësimdhënies, mundësi më të mëdha për shkëmbim të përvojave përmes mobilitetit si dhe qasje në resurse të databazave ndërkombëtare, që ndërlidhen me sigurimin e cilësisë në mësimdhënie. Brenda periudhës pesëvjeçare, strategjia synon të rrisë numrin e të diplomuarve për 15%, sikurse edhe nivelin e vlerësimeve nga ana e studentëve. Për më tepër, ky objektivi synon që brenda periudhës së zbatimit të strategjisë rreth 50% e stafit akademik të marrin pjesë në trajnime në lidhje me mësimdhënien dhe rreth 80% e stafit të kenë kualifikimet e duhura. Për më tepër, strategjia synon që brenda tre vjetëve të arrihen të paktën edhe pesë marrëveshje ndërkombëtare bashkëpunimi, për të mundësuar qasje në shkëmbimin e përvojave përmes mobilitetit.

Objektivi Strategjik Nr. 1 – Ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie	
Objektivi specifik 1.1: Inkurajimi i ekselencës në mësimdhënie me metoda të reja	
Treguesit	Vlera e synuar 2025
Norma më të larta të diplomimit	15% rritje nga numri aktual
Komente/vlerësime nga ana e studentëve	15% rritje nga numri aktual
Kualifikimet e stafit akademik	80% e stafit akademik kanë kualifikimet e duhura
Trajnimi i vazhdueshëm i stafit akademik	50% e personelit akademik ka marrë pjesë në trajnime në lidhje me mësimdhënien të paktën një herë me minimumin 6 orë
Të ofrohen trajnime të brendshme mbi metodologjitë e reja të mësimdhënies	10 grupe trajnime
Qasje në shkëmbimin e përvojave	5 marrëveshje bashkëpunimi ndërkombëtare të reja
Qasja në resurse të cilësisë	Qasja në të paktën një databazë ndërkombëtare më shumë

Objektivi Strategjik Nr. 1 – Ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie

Objektivi specifik 1.1: Inkurajimi i ekselencës në mësimdhënie me metoda të reja

Veprimet e planifikuara

1.1.1	Zhvillimi i kurseve të specializuara për stafin e mësimdhënies në teknikat dhe metodologjitë e reja të mësimdhënies
1.1.2	Inkurajimi i një qasjeje më aktive dhe praktike për mësimin përmes zhvillimit të aktiviteteve të mësimdhënies bazuar në projekte
1.1.3	Sigurimi që studentët të kenë akses në teknologjitë dhe mjetet më të fundit për të mësuar
1.1.4	Krijimi i një kulture të ndryshimit dhe inovacionit në mësimdhënie nëpërmjet konkurrencës dhe ndarjes së praktikave të mira mes mësimdhënësve
1.1.5	Ngritja e programeve dhe bursave për mësimdhënësit dhe studentët për të studiuar dhe praktikuar metodologjitë e reja të mësimdhënies në nivel ndërkombëtar

Objektivi specifik 1.2. Rishikimi dhe avancimi i programeve të studimit

Ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie synohet të arrihet edhe përmes rishikimit dhe avancimit të programeve të studimit. Ky objektivi specifik do të matet duke vlerësuar shkallën e suksesit të studentëve në provime, me ç'rast synohet që brenda tre vjetëve të ardhshëm të rritet shkalla e kalueshmërisë prej 10%. Tregues tjetër për arritjet e këtij objektivi do të jetë niveli i diplomimit të studentëve. Strategjia synon të rrisë nivelin e diplomimit për 15%. Në përqindje të njëjtë synohet të rritet edhe numri i kandidatëve që aplikojnë për të studiuar në UP. Në anën tjetër, strategjia synon që edhe shkalla e punësimit të studentëve pas diplomimit të rritet për 15%. Ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie synohet të arrihet edhe përmes përdorimit të teknologjisë së re informative dhe materialeve moderne studimore. Këta tregues do të maten duke prezantuar platforma të reja inovative të mësimin sikurse krijimi i podkasteve dhe webinarëve.

Objektivi Strategjik Nr. 1 – Ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie**Objektivi specifik 1.2: Rishikimi dhe avancimi i programeve të studimit**

Treguesit	Vlera e synuar 2025
Shkalla e suksesit të studentëve në provime	Rritja e kalueshmërisë prej 10% më shumë
Shkalla e diplomimit të studentëve	15% rritje nga numri aktual
Përdorimi i pajisjeve të TI-së në mësimdhënie	Prezantimi i platformave të reja, prezantimi i kriterëve të reja të vlerësimit dhe detyrave të shtëpisë sikurse krijimi i podkasteve, shkrimi i një artikulli Wiki e të tjera.
Rritja e numrit të kandidatëve për të studiuar në UP	15% rritje në numrin e aplikantëve
Materiale moderne studimore	Podkaste shtesë si material studimor, leksione shtesë të regjistruara paraprakisht
Shkalla e punësimit të studentëve pas diplomimit	15% rritje nga numri aktual
Veprimet e planifikuara	
1.2.1	Hartimi i kurrikulave efektive
1.2.2	Krijimi i programeve të reja të studimit me diploma të dyfishta dhe diploma të përbashkëta
1.2.3	Analiza e nevojave të tregut të punës dhe promovimi i bashkëpunimit me industrinë
1.2.4	Konsultime me studentët dhe mësimdhënësit dhe monitorimi i performancës së studentëve
1.2.5	Promovimi i programit të studimit për të rritur ndërgjegjësimin dhe interesin e studentëve dhe punëdhënësve

Objektivi specifik 1.3. Zbatimi i standardeve të larta të vlerësimit institucional dhe programeve të studimit

Ngritja e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies synohet të arrihet edhe përmes zbatimit të standardeve të larta të vlerësimit institucional. Standardet e vlerësimit do të kontribuojnë në sigurimin e cilësisë së brendshme. Kjo do të matet duke vlerësuar performancën akademike të studentëve, rritjen e përfshirjes së profesorëve ndërkombëtarë, zhvillimin e programeve të brendshme të trajnimit, mobilitetin në mësimdhënie dhe rritjen e shkallës së kënaqshmërisë së studentëve me përmbajtjen e programit të studimit. Zbatimi i këtyre aktiviteteve do të kontribuojë në rritjen e shkallës së diplomimit për të paktën 15%.

Objektivi Strategjik Nr. 1 – Ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie	
Objektivi specifik 1.3: Zbatimi i standardeve të larta të vlerësimit institucional dhe programeve të studimit	
Treguesit	Vlera e synuar 2025
Performanca akademike e studentëve	15% rritje e shkallës së diplomimit
Përfshirja e profesorëve ndërkombëtarë	15% rritje nga numri aktual
Programe për zhvillimin profesional të stafit akademik	Zhvillimi i dy programeve të brendshme të trajnimit
Vlerësimi nga ana e kolegëve	Shkëmbimi në mësimdhënie
Performanca e stafit akademik në mësimdhënie	10% rritje e shkallës së kënaqshmërisë me përmbajtjen e programit të studimit
Veprimet e planifikuara	
1.3.1	Identifikimi i standardeve të vlerësimit për sigurimin e cilësisë së brendshme
1.3.2	Zhvillimi i planeve të vlerësimit
1.3.3	Kryerja e vlerësimit dhe monitorimit të rregullt
1.3.4	Analiza dhe interpretimi i e të dhënave
1.3.5	Përmirësimi i performancës

Objektivi specifik 1.4. Rritja e përfshirjes dhe angazhimit të studentëve

Një ndër objektivat specifikë në kuadër të objektivit të parë strategjik është edhe rritja e përfshirjes së studentëve në vendimmarrje. Kjo do të mundësohet përmes plotësimit apo nxjerrjes së rregulloreve të reja. Ky objektivi synon edhe rritjen e mundësive për angazhimin e studentëve si asistentë në mësimdhënie dhe në projekte kërkimore. Kjo do të arrihet edhe duke shtuar mundësitë për shërbime të veçanta për konsultime. Strategjia synon edhe rritjen e angazhimit të universitetit për të ndihmuar studentët të gjejnë punë praktike. Për më tepër, strategjia synon edhe rritjen e investimeve për organizatat studentore dhe kjo do të kontribuojë në rritjen prej të paktën 20% të aktiviteteve të organizuara nga studentët. Ky objektivi specifik parasheh edhe rritjen e aktiviteteve të alumnit të UP-së, duke ndihmuar në organizimin e të paktën tri ngjarjeve në vit.

Objektivi Strategjik Nr. 1 – Ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie	
Objektivi specifik 1.4: Rritja e përfshirjes dhe angazhimit të studentëve	
Treguesit	Vlera e synuar 2025
Përfshirja e përfaqësuesve të studentëve në vendimmarrje	Nxjerrja e rregulloreve të reja
Përfshirja e studentëve në cilësinë e asistentëve hulumtues	15 asistentë hulumtues me pagesë
Investime për organizatat studentore	20% më shumë të numrit të aktiviteteve të organizuara nga studentët
Ofrimi i mundësive për konsultim	Studentëve u ofrohen shërbime të veçanta shtesë për konsultime
Ofrimi i këshillave dhe mbështetjes emocionale	Personeli i universitetit (stafi, studentët dhe punëtorët teknik) kanë shërbime për trajtimin e çështjeve emocionale
Rritja e numrit të ngjarjeve nga ana e alumnit	3 ngjarje në vit
Asistimi i studentëve të gjejnë punë praktike	20% më shumë i numrit të studentëve që aplikojnë për punë praktike

Objektivi Strategjik Nr. 1 – Ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie

Objektivi specifik 1.4: Rritja e përfshirjes dhe angazhimit të studentëve

Veprimet e planifikuara

1.4.1	Promovimin e të nxënit bashkëpunues dhe ofrimin e mundësive për studentët që të përfshihen në kërkim
1.4.2	Përfshirja e studentëve në sigurimin e cilësisë
1.4.3	Përmirësimi i mirëqenies emocionale të studentëve përmes themelimit të Qendrës Këshilluese
1.4.4	Krijimi i klubeve të interesit që mund të ndihmojnë në nxitjen e angazhimit dhe krijimin e lidhjeve me studentët si dhe organizimi i aktiviteteve sociale dhe kulturore
1.4.5	Mundësimi i punës vullnetare që mund të ndihmojnë në rritjen e ndjeshmërisë sociale dhe në zhvillimin e aftësive të ndryshme

Objektivi specifik 1.5. Rritja e performancës akademike

Rritja e performancës akademike ndikon direkt në ngritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Për ta arritur këtë objektiv, universiteti do të angazhohet që karta e performancës të zbatohet në përpikëri, ofrimi i të paktën 10 trajnimeve speciale, të cilat mbështesin të mësuarit, dhe ofrimi i qasjes në resurse të cilësisë përmes qasjes në databaza ndërkombëtare. Për më tepër, ky objektiv strategjik synon që të rrisë edhe nivelin e punës në grupe dhe diskutimeve në ligjërata. Ndër veprimet e planifikuara është edhe njohja dhe shpërblimi i përsosmërisë në mësimdhënie dhe kërkime.

Objektivi Strategjik Nr. 1 – Ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie**Objektivi specifik 1.5: Rritja e performancës akademike**

Treguesit	Vlera e synuar 2025
Vlerësimi në Kartën e Performancës	Kartat e performancës zbatohen me përpikëri
Metodat e vlerësimit mbështesin të mësuarit	Prezantimi i metodave të reja të vlerësimit, 10 trajnimeve speciale
Studentët kanë qasje në resurse të cilësisë	Qasje në të paktën dy databaza ndërkombëtare më shumë
Puna në grupe dhe diskutimet në ligjërata	20% numër më i madh i punës në grupe
Veprimet e planifikuara	
1.5.1	Krijimi i sistemeve efektive të vlerësimit
1.5.2	Promovimi i integritetit akademik
1.5.3	Njohja dhe shpërblimi i përsosmërisë në mësimdhënie dhe kërkime
1.5.4	Investimi në infrastrukturë dhe burime
1.5.5	Përqendrimi në programet e specializuara

Objektivi strategjik 2: Avancimi i shkencës, inovacionit dhe ndërlidhja me tregun e punës

Përmes avancimit të shkencës dhe inovacionit, strategjia synon të bëhet edhe ndërlidhja me tregun e punës. Për ta arritur këtë objektivi, strategjia parasheh rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete kërkimore, përmes rritjes së pjesëmarrësve me kualifikime të avancuara në fushën e shkencës dhe inxhinierisë, përmes rritjes së outputeve për njohuritë relevante që i përgjigjën ekonomisë/tregut, si dhe njohuritë për patentimet nga këto institucione. Po ashtu synohet edhe krijimi i grupit të përbashkët ndërkombëtar për rritjen e ndikimit të studiuesve vendas në zhvillimin global përmes projekteve sikurse Horizon Europe, si dhe përmes përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese dhe zhvillimit të objekteve të reja për të mbështetur hulumtimin shkencor.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2	Avancimi i shkencës, inovacionit dhe ndërlidhja me tregun e punës
Objektivi specifik	2.1. Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në avancimin e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit
Objektivi specifik	2.2. Rritje e pjesëmarrësve me kualifikime të avancuara në fushën e shkencës dhe inxhinierisë
Objektivi specifik	2.3. Rritja e outputeve për njohuritë relevante që i përgjigjen tregut të punës
Objektivi specifik	2.4. Krijimi i grupit të përbashkët ndërkombëtar për rritjen e ndikimit të studiuesve vendas
Objektivi specifik	2.5. Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese dhe zhvillimi i objekteve të reja për të mbështetur hulumtimin shkencor

Objektivi specifik 2.1. Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në avancimin e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit

Strategjia parasheh veprime konkrete me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së të rinjve në avancimin e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit. Të paktën dhjetë grante në vit parashihen të ofrohen për studiuesit dhe hulumtuesit e rinj. Me qëllim të shkëmbimit të përvojave, strategjia parasheh mentorim të veçantë të studiueseve të rinj nga kolegët e tyre më të vjetër. Kjo do të ndikojë edhe në rritjen e studentëve si asistentë hulumtues. Strategjia parasheh edhe mundësi/trajtime për vetëzhvillim në fushën e specializimit si dhe tërheqjen e alumnit për të punuar në UP.

Objektivi Strategjik Nr. 2 – Avancimi i shkencës, inovacionit dhe ndërlidhja me tregun e punës

Objektivi specifik 2.1: Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në avancimin e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit

Treguesit	Vlera e synuar 2025
Grante për studiuesit/hulumtuesit e rinj	10 grante në vit
Mundësi mentorimi të studiuesve/hulumtuesve të rinj	Mentorim i veçantë i ofruar nga kolegët më të vjetër
Përfshirja e studentëve si asistent hulumtues	10% më shumë asistent hulumtues
Përfshirja e organizatave studentore në marrjen e vendimeve	2 përfaqësues të studentëve në organet vendimmarrëse
Mundësi/trajnime për vetë-zhvillim në fushën e specializimit	500 euro në vit për çdo akademik të ri
Joshja e alumnit për të punuar në UP	Fushata speciale
Veprimet e planifikuara	
2.1.1	Krijimi i grupeve të përbashkëta hulumtuese shkencore me universitetet tjera ndërkombëtare, me qëllim të krijimit të platformave për aplikim në programe/grande evropiane (si Horizon Europe etj.)
2.1.2	Lidhja e rezultateve shkencore me ekonominë dhe aplikimi i drejtpërdrejtë me industri si dhe patentimi i tyre
2.1.3	Zhvillimi i kërkesave për hulumtime shkencore duke përmirësuar infrastrukturën ekzistuese me fokus në laboratorë dhe hapësira përcjellëse me qëllim të arritjes së synimeve të ekuivalentimit me universitetet tjera.
2.1.4	Tendenca për krijimin e PhD të përbashkëta sipas marrëveshjeve me universitetet tjera ndërkombëtare dhe targetimit për Double diplome PhD
2.1.5	Rritja e bashkëpunimit me kërkesat e tregut kombëtar dhe ndërkombëtar përmes adaptimit/përshtatjes/ të programeve ekzistuese të studimeve dhe tendenca për programe të reja konform kërkesave të tregut

Objektivi specifik 2.2. Rritje e pjesëmarrësve me kualifikime të avancuara në fushën e shkencës dhe inxhinierisë

Duke rritur bashkëpunimin me palët e interesit, strategjia synon të rrisë mundësitë për skema të punësimit afatshkurtër dhe afatgjatë. Ndër veprimet kryesore për arritjen e këtij objekti është edhe organizimi i tryezave të përbashkëta me grupet e interesit dhe organizimi i punëtorive.

Objektivi Strategjik Nr. 2 – Avancimi i shkencës, inovacionit dhe ndërlidhja me tregun e punës	
Objektivi specifik 2.2: Rritje e ndjeshme e pjesëmarrësve me kualifikime të avancuara në fushën e shkencës dhe inxhinierisë (nga universitetet e huaja dhe industria)	
Treguesit	Vlera e synuar 2025
Skema shtesë për punësim afatshkurtër	Persona të rinj të punësuar
Skema shtesë për punësim afatgjatë	Persona të rinj të punësuar
Skemat e shkëmbimit	Persona të rinj të punësuar
Veprimet e planifikuara	
2.2.1	Të dhënat për interesimin e zhvillimit të fushave specifike si kërkesa nga UP-ja dhe ekonomia vendore.
2.2.2	Baza e grupeve në dispozicion për arritjen e objektivave në fushat përkatëse.
2.2.3	Organizimi i tryezave të përbashkëta me palët e interesit.
2.2.4	Krijimi i grupeve të fushave të ngushta me orientime drejt avancimeve për arritjen e caktit të dëshiruar.
2.2.5	Organizimi i punëtorive me fokus nga universitetet vendore dhe të jashtme si dhe bordet këshillëdhënëse.

Objektivi specifik 2.3. Rritja e outputeve për njohuritë relevante që i përgjigjen tregut të punës

Arritja e këtij objekti fillon me identifikimin e kërkesave të industrisë dhe përafrimin e programeve të studimit konform kërkesave të tregut të punës. Ky objektiv parasheh shtimin e projekteve kërkimore për 10% më shumë projekte, si dhe rritjen e numrit të patentimeve

për 10% më shumë. Të arriturat e patentimeve do të publikohen në revistat të indeksuara shkencore. Strategjia synon rritjen e numrit të publikimeve në top revista shkencore për 10% më shumë publikime. Ndërlidhja me nevojën e tregut të punës parasheh edhe rritjen e financimit nga sektori privat përmes shërbimeve të ofruara nga universiteti.

Objektivi Strategjik Nr. 2 – Avancimi i shkencës, inovacionit dhe ndërlidhja me tregun e punës	
Objektivi specifik 2.3: Rritja e outputeve për njohuritë relevante që i përgjigjën ekonomisë/tregut, si dhe njohuritë për patentimet nga këto institucione	
Treguesit	Vlera e synuar 2025
Publikime në top revistat shkencore për nga cilësia	10% më shumë publikime
Projekte kërkimore	10% më shumë projekte
Numri i patentimeve	10% më shumë
Financim nga sektori privat	30% rritje e fondeve
Veprimet e planifikuara	
2.3.1	Identifikimi i kërkesave të industrisë dhe përafrimi me përditësimin e programeve studimore.
2.3.2	Krijimi i grupeve me fokus nga ekonomia të udhëhequra nga stafi i UP-së, duke shfrytëzuar qendrën e inovacionit.
2.3.3	Formimi i grupeve, duke përfshirë edhe studentë të nivelit MSc dhe PhD në përgatitjen e prototipave dhe modelet.
2.3.4	Të arriturat e patentimeve të publikohen në revista të indeksuara me target shkencor.
2.3.5	Implementimi i rezultateve dalëse dhe nevoja për adaptime pas aplikimit

Objektivi specifik 2.4. Krijimi i grupit të përbashkët ndërkombëtar për rritjen e ndikimit të studiuesve vendas

Përmes projekteve si Horizon Europe dhe të ngjashëm, strategjia synon krijimin e një grupi të përbashkët ndërkombëtar për rritjen e ndikimit të studiuesve vendor në zhvillimin global. Kjo qasje nënkupton krijimin e kontakteve me universitete ndërkombëtare me qëllim

të krijimit të konsorciumeve për aplikim të përbashkët në projekte ndërkombëtare. Suksesi i zbatimit të këtij objekti do të matej duke rritur numrin e aplikimeve në projekte ndërkombëtare për të paktën 10 aplikime në vit si dhe duke rritur numrin e kërkimeve të përbashkëta shkencore në të paktën 15 kërkime në vit.

Objektivi Strategjik Nr. 2 – Avancimi i shkencës, inovacionit dhe ndërlidhja me tregun e punës	
Objektivi specifik 2.4: Krijimi i grupit të përbashkët ndërkombëtar për rritjen e ndikimit të studiuesve vendas në zhvillimin global përmes projekteve (Horizont Europe, etj).	
Treguesit	Vlera e synuar 2025
Numri i projekteve ndërkombëtare të financuara	Të paktën 2 aplikime në vit
Studime/publikime të përbashkëta shkencore	Të paktën 15 studime të përbashkëta në vit
Numri i aplikimeve ndërkombëtare	Të paktën 10 aplikime në vit
Veprimet e planifikuara	
2.4.1	Hulumtimi i kërkesave dhe afateve për aplikim në projekte ndërkombëtare
2.4.2	Kontakti me personat të zyrës së projekteve të universiteteve ndërkombëtare për pjesëmarrje në konsorcium të përbashkët.
2.4.3	Përcjellja e afateve për plotësim të dokumentacionit në bashkëpunim me zyrën e projekteve në kuadër të UP-së.
2.4.4	Përfitimet e njohurive dhe përvojave nga aplikimet e ngjashme me universitetet ndërkombëtare.
2.4.5	Analiza e mundësive për vazhdim në aplikim në projekte.

Objektivi specifik 2.5. Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese dhe zhvillimi i objekteve të reja për të mbështetur hulumtimin shkencor

Avancimi i shkencës dhe inovacionit synon të arrihet edhe përmes përmirësimit të infrastrukturës ekzistuese dhe zhvillimit të objekteve të reja për të mbështetur hulumtimin shkencor. Kjo nënkupton rritjen e buxhetit për zhvillimin e infrastrukturës digjitale, rritjen e qasjes

në databaza të ndryshme ndërkombëtare, si dhe përmes investimeve direkte në salla, objekte dhe laboratorë për zhvillimin e kërkimeve shkencore.

Objektivi Strategjik Nr. 2 – Avancimi i shkencës, inovacionit dhe ndërlidhja me tregun e punës	
Objektivi specifik 2.5: Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese dhe zhvillimi i objekteve të reja për të mbështetur hulumtimin shkencor	
Treguesit	Vlera e synuar 2025
Zhvillimi i infrastrukturës digjitale	Rritja e buxhetit për këtë qëllim
Qasje në databaza të ndryshme ndërkombëtare	Rritja e buxhetit për këtë qëllim
Investime në laboratorë/objekte për zhvillimin e kërkimeve shkencore	Rritja e buxhetit për këtë qëllim
Përmirësimi i kushteve sportive dhe rekreative	Ndërtimi i infrastrukturës së re sportive
Investime në salla dhe objekte	Rritja e numrit të sallave, objekte të veçanta
Veprimet e planifikuara	
2.5.1	Hulumtimi i kërkesave të tregut dhe përshtatja me infrastrukturën ekzistuese për Start-Upe të reja.
2.5.2	Krijimi i hapësirave të reja për Start-Up, për fushat specifike (Mjekësi, Inxhinieri etj.)
2.5.3	Ftesa dhe ofrimi i hapësirave për kompanitë për zhvillimin e produkteve në kuadër të parkut teknologjik.
2.5.4	Realizimi i bashkëpunimeve në rritjen e objekteve dhe infrastrukturës së re për qasje inovative.
2.5.5	Krijimi i buxhetit të qëndrueshëm nga të hyrat e bizneseve dhe institucionet tjera vendore dhe ndërkombëtare si dhe institucionet publiko-private.
2.5.6	Ndërtimi i Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit.

Objektivi strategjik 3: Përmirësimi i pozitës dhe rolit të UP-së në skenën ndërkombëtare

Objektivi i tretë strategjik synon përmirësimin e dukshëm të pozitës dhe rolit të UP-së në skenën ndërkombëtare. Kjo synohet të arrihet përmes rritjes së mundësive të studimit dhe kërkimit në UP për studentët dhe studiuesit ndërkombëtarë, rritjes së pjesëmarrjes në programe ndërkombëtare të bashkëpunimit akademik dhe shkencor, përmirësimit të brendit të UP-së në rangimin botëror, zgjerimit të mundësive për studentët dhe hulumtuesit e UP-së për të kryer studime dhe kërkime jashtë vendit, si dhe përmes rritjes së njohurive ndërkulturore.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3	Përmirësimi i pozicionit dhe rolit të UP-së në skenën ndërkombëtare
Objektivi specifik	3.1. Rritja e mundësive të studimit dhe kërkimit në UP për studentë dhe studiues ndërkombëtarë
Objektivi specifik	3.2. Përmirësimi i pjesëmarrjes në programet ndërkombëtare të bashkëpunimit akademik dhe shkencor
Objektivi specifik	3.3. Rritja e njohjes dhe vlerësimit global të UP-së
Objektivi specifik	3.4. Zgjerimi i mundësive për studentët dhe hulumtuesit e UP-së për të kryer studime dhe kërkime jashtë vendit
Objektivi specifik	3.5. Rritja e kompetencës ndërkulturore

Objektivi specifik 3.1. Rritja e mundësive të studimit dhe kërkimit në UP për studentë dhe studiues ndërkombëtarë

Përmirësimi i pozitës së UP-së në skenën ndërkombëtare do të fillojë nga rritja e mundësive për studentë dhe hulumtues shkencor ndërkombëtarë. Konkretisht, brenda tre vjetëve, strategjia synon të rrisë numrin e studentëve ndërkombëtarë prej 20% nga numri aktual, kurse numrin e profesorëve ndërkombëtarë ta rrisë për 15%. Tregues matës do të përdoren edhe numri i projekteve të përbashkëta

ndërkombëtare si dhe kërkimet shkencore të përbashkëta me universitetet tjera, ku synohet që ky numër të rritet për 10%. Veprimet e planifikuara në kuadër të këtij objektivit strategjik janë ofrimi i bursave dhe paketave ndihmuese financiare, ofrimi i kurseve në gjuhë të huaja dhe i diplomave të dyfishta në bashkëpunim me universitete ndërkombëtare. Këto veprime pritet të bazohen në një strategji të re të marketingut.

Objektivi Strategjik Nr. 3 – Përmirësimi i pozitës dhe rolit të UP-së në skenën ndërkombëtare	
Objektivi specifik 3.1: Rritja e mundësive të studimit dhe kërkimit në UP për studentë dhe studiues ndërkombëtarë	
Treguesit	Vlera e synuar 2025
Numri i studentëve ndërkombëtarë	20% rritje nga numri aktual
Numri i profesorëve ndërkombëtarë	15% rritje nga numri aktual
Projektet ndërkombëtare	10% më shumë projekte ndërkombëtare
Kërkime shkencore të përbashkët me universitete të tjera	10% rritje nga numri aktual
Veprimet e planifikuara	
3.1.1	Strategji të synuara marketingu dhe rekrutimi
3.1.2	Ofrimi i bursave konkurruese dhe paketa ndihme financiare
3.1.3	Ofrimi i kurseve dhe programeve akademike në gjuhë të huaj/diploma të përbashkëta dhe diploma të dyfishta
3.1.4	Zhvillimi i databazës funksionale për shërbimet e ndërkombëtarizimit
3.1.5	Krijimi i partneritetit me agjenci dhe institucione ndërkombëtare

Objektivi specifik 3.2. Përmirësimi i pjesëmarrjes në programet ndërkombëtare të bashkëpunimit akademik dhe shkencor

Krijimi i partneriteteve me universitete dhe institucione kërkimore ndërkombëtare, përkrahja e stafit për projekte të përbashkëta për marrjen e fondeve ndërkombëtare dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për ndërkombëtarizim dhe zhvillim të projekteve, do të kontribuojnë në përmirësimin e pozitës së UP-së në skenën ndërkombëtare. Përmirësimi i pjesëmarrjes në programe të bashkëpunimit akademik dhe shkencor po ashtu do të rezultojë në rritjen e numrit të botimeve të përbashkëta, rritjen e programeve të shkëmbimit si dhe në rritjen e numrit të studentëve që shkojnë për një semestër jashtë vendit.

Objektivi Strategjik Nr. 3 – Përmirësimi i pozitës dhe rolit të UP-së në skenën ndërkombëtare	
Objektivi specifik 3.2: Përmirësimi i pjesëmarrjes në programet ndërkombëtare të bashkëpunimit akademik dhe shkencor	
Treguesit	Vlera e synuar 2025
Numri i botimeve të përbashkëta	10% rritje nga numri aktual
Numri i programeve të shkëmbimit	15% rritje nga numri aktual
Numri i studentëve që shkojnë për një semestër jashtë vendit	10% rritje nga numri aktual
Numri i projekteve të përbashkëta	10% rritje nga numri aktual
Numri i aplikimeve të përbashkëta	20% rritje nga numri aktual
Veprimet e planifikuara	
3.2.1	Krijimi i partneriteteve me universitete dhe institucione kërkimore kryesore ndërkombëtare
3.2.2	Përkrahja e stafit për projekte të përbashkëta për marrjen e fondeve ndërkombëtare
3.2.3	Forcimi i kapaciteteve institucionale për ndërkombëtarizim dhe zhvillim të projekteve
2.2.4	Përfshirja e diasporës në hulumtime dhe programe mobiliteti

Objektivi specifik 3.3. Rritja e njohjes dhe vlerësimit global të UP-së

Strategjia parasheh disa veprime konkrete për të përmirësuar brendin dhe reputacionin global të UP-së. Në tre vitet e ardhshme, strategjia synon të arrihen tre marrëveshje të reja partneriteti me universitete të tjera. Tregues matës i këtij objekti do të jetë ngritja e rangimit të UP-së në Webometrics dhe New Times Higher Education. Përmes krijimit të një plani të marketingut dhe krijimit të një plani të mediave sociale, UP-ja do të rrisë prezencën e saj duke publikuar me rregull në këto platforma. Shkëmbimi ndërkombëtar i studentëve dhe përfshirja e stafit mësimdhënës ndërkombëtar do të ndikojnë direkt në rritjen e njohjes dhe vlerësimit të UP-së në skenën ndërkombëtare.

Objektivi Strategjik Nr. 3 – Përmirësimi i pozitës dhe rolit të UP-së në skenën ndërkombëtare	
Objektivi specifik 3.3: Rritja e njohjes dhe vlerësimit global të UP-së/Përmirësimi i brendit dhe reputacionit global	
Treguesit	Vlera e synuar 2025
Bashkëpunimi me universitete të tjera	5 marrëveshje të reja partneriteti
Ngritja e rangimit në profilin e universitetit global (Webometrics, New Times Higher Education etj.)	Renditur në Times Higher Education dhe renditet 500-1000 në Webometrics
Përfshirja e stafit mësimdhënës ndërkombëtar	50% rritje nga numri aktual
Shkëmbimi ndërkombëtar i studentëve	50% rritje nga numri aktual
Bashkëpunim me specialistë marketingu në universitete të tjera	Një rrjet prej të paktën 6 specialistësh marketingu
Krijimi i një plani marketingu	Promovimi me rregull sipas planit
Krijimi i një plani të mediave sociale	Publikimi me rregull në të paktën 3 platforma të mediave sociale
Zhvillimi i kurrikulave në anglisht	2 kurrikula shtesë në anglisht
Mundësi për të mësuar një gjuhë të huaj	Disa gjuhë të huaja në dispozicion
Pjesëmarrja në konferenca shkencore ndërkombëtare	Rritja e pjesëmarrjes së stafit akademik në konferenca shkencore ndërkombëtare

Objektivi Strategjik Nr. 3 – Përmirësimi i pozitës dhe rolit të UP-së në skenën ndërkombëtare

Objektivi specifik 3.3: Rritja e njohjes dhe vlerësimit global të UP-së/Përmirësimi i brendit dhe reputacionit global

Veprimet e planifikuara

3.3.1	Krijimi i strategjisë gjithëpërfshirëse të brendit dhe marketingut. Krijimi i një ndjesie të fortë të identitetit duke ndërtuar marrëdhënie afatgjata me studentët, stafin, donatorët dhe komunitetin në përgjithësi
3.3.2	Ridizajnimi dhe ri strukturimi i platformës digjitale (ueb faqes, media sociale etj)
3.3.3	Promovimi i arritjeve dhe renditjeve ndërkombëtare të universitetit nëpërmjet platformave të mediave digjitale dhe sociale
3.3.4	Përmirësimi i komunikimit me publikun
3.3.5	Krijimi i Qendres Mediale dhe kanalit zyrtar në platformat online

Objektivi specifik 3.4. Zgjerimi i mundësive për studentët dhe hulumtuesit e UP-së për të kryer studime dhe kërkime jashtë vendit

Zgjerimi i mundësive për studentët dhe hulumtuesit e UP-së për të kryer studime dhe kërkime jashtë vendit do të fillojë me azhurnimin dhe promovimin me rregull të uebfaqes *Study Abroad*. Kjo faqe do të përmbajë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët dhe personelin. Brenda tre vjetëve, strategjia synon që numri i studentëve që shkojnë për, të paktën, një semestër jashtë vendit të rritet në 50% nga numri aktual, kurse numri i stafit akademik që ligjëron për, të paktën, një javë jashtë vendit të rritet për 40%. Shkëmbime parashihen edhe te stafi administrativ.

Objektivi Strategjik Nr. 3 – Përmirësimi i pozitës dhe rolit të UP-së në skenën ndërkombëtare

Objektivi specifik 3.4: Zgjerimi i mundësive për studentët dhe hulumtuesit e UP-së për të kryer studime dhe kërkime jashtë vendit

Treguesit	Vlera e synuar 2025
Numri i studentëve që shkojnë për të paktën një semestër jashtë vendit	50% rritje nga numri aktual
Numri i stafit akademik që ligjëron për, të paktën, një javë jashtë vendit	40% rritje nga numri aktual
Numri i stafit administrativ që merr pjesë në aktivitete për shkëmbim të stafit që zgjasin, të paktën, një javë	100% rritje nga numri aktual
Uebfaqja mbi <i>Study Abroad</i> përmban të gjitha informacionet e duhura	Uebfaqja azhurnohet dhe promovohet të paktën një herë në gjashtë muaj
Skema gjithëpërfshirëse për bashkëpunim ndërkombëtar	Të paktën 20 takime për përgatitje të projekteve financohen nga resurset qendrore
Numri i departamenteve që kanë projekte aktive ndërkombëtare	50% rritje nga numri aktual
Veprimet e planifikuara	
3.4.1	Ofrimi i programeve për studim/hulumtim jashtë vendit
3.4.2	Ofrimi i bursave/granteve për studim/hulumtim jashtë vendit
3.4.3	Zhvillimi i partneriteteve me universitetet ndërkombëtare për programet e shkëmbimit (Erasmus, CEEPUS, MEVLANA, etj)
3.4.4	Hartimi i rregulloreve për lehtësim të mobilitet akademik

Objektivi specifik 3.5. Rritja e kompetencës ndërkulturore

Rritja e kompetencës ndërkulturore synohet të arrihet duke shtuar numrin e ngjarjeve ndërkulturore që kanë për qëllim studentët, si dhe duke shtuar numrin e trajnimeve për stafin akademik. Ndër veprimet tjera që parashihen janë edhe rritja e inovacioneve në organizimin dhe përmbajtjen e UVP-së dhe javës ndërkombëtare dhe integrimin e çështjeve dhe perspektivave globale në kurrikulë. Tregues për matjen e këtij objekti do të jetë edhe rritja e numrit të studentëve të huaj që studiojnë për një semestër në UP.

Objektivi Strategjik Nr. 3 – Përmirësimi i pozitës dhe rolit të UP-së në skenën ndërkombëtare	
Objektivi specifik 3.5: Rritja e kompetencës ndërkulturore	
Treguesit	Vlera e synuar 2025
Organizimi i ngjarjeve ndërkulturore që kanë për qëllim studentët	6 ngjarje në vit
Numri i trajnimeve për stafin për rritjen e njohurive ndërkulturore	3 ngjarje në vit
Numri i praktikantëve ndërkombëtarë	20 praktikant më shumë
Numri i studentëve shkëmbyes që studiojnë në UP secilin semestër	100% rritje nga numri aktual
Numri i lëndëve inovative në kurrikulë studimore	50% rritje nga numri i tanishëm
Veprimet e planifikuara	
3.5.1	Krijimi i këndeve ndërkombëtare
3.5.2	Organizimin e ngjarjeve kulturore ndërkombëtare
3.5.3	Inovacion në organizimin dhe përmbajtjen e UVP-së dhe javës ndërkombëtare
3.5.4	Integrimin e çështjeve dhe perspektivave globale në kurrikulë
3.5.5	Krijimi i <i>international week</i>

Objektivi strategjik 4: Digjitalizimi dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike

Objektivi i katërt i Strategjisë së UP-së është digjitalizimi i shërbimeve të UP-së dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike. Ky objektivi do të arrihet përmes digjitalizimit të shërbimeve administrative të UP-së, digjitalizimit të shërbimeve mësimore, përmirësimit të teknologjisë së informimit dhe komunikimit brenda sallave mësimore, zhvillimit të njohurive digjitale të stafit dhe studentëve dhe përmes azhurnimit të politikave dhe proceseve për digjitalizim.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 4	Digjitalizimi dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike
Objektivi specifik	4.1. Digjitalizimi i shërbimeve administrative brenda universitetit
Objektivi specifik	4.2. Digjitalizimi i shërbimeve mësimore brenda universitetit
Objektivi specifik	4.3. Përmirësimi i teknologjisë së informimit dhe komunikimit brenda sallave mësimore
Objektivi specifik	4.4. Zhvillimi i njohurive digjitale të stafit dhe studentëve
Objektivi specifik	4.5. Azhurnimi i politikave dhe proceseve për digjitalizim

Objektivi specifik 4.1. Digjitalizimi i shërbimeve administrative brenda universitetit

Ky objektivi synon t'i lehtësojë dhe thjeshtëzojë procedurat administrative sikurse aprovimin dhe procesimin e faturave, përdorimin e nënshkrimit digjital dhe sistemit të informimit të studimeve. Ofrimi i shërbimeve të reja digjitale kërkon edhe veprime rreth ristrukturimit të departamentit të TI-së konform strategjisë digjitale të universitetit. Zhvillimi i doracakëve dhe trajnimi i stafit në përdorimin e funksioneve të reja digjitale është po ashtu ndër veprimet e parapara në këtë objektivi.

Objektivi Strategjik Nr. 4 – Digjitalizimi dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike

Objektivi specifik 4.1: Digjitalizimi i shërbimeve administrative brenda universitetit

Treguesit	Vlera e synuar 2025
Procesi i aprovimit të faturave është thjeshtëzuar	Më së shumti tre persona aprovojnë secilën faturë
Koha e procesimit të faturave	Secila faturë procesohet më së largu brenda një jave
Sistemi i informimit të studimeve	Një sistem i ri i informimit është në dispozicion
Statistikat që kanë të bëjnë me studimet	Statistikat më të rëndësishme rreth studimeve janë të qasshme dhe të azhuruara
Protokollet e trupave vendimmarrës	Protokollet e trupave vendimmarrës, përfshirë argumentimet kryesore publikohen brenda tre ditësh pas mbledhjes
Ndarja proaktive e informacionit	Lajmet kryesore rreth universitetit publikohen të paktën një herë në javë/muaj
Nënshkrimi digjital	Sistemi i nënshkrimit digjital përdoret kudo në UP
Raportet dhe të dhënat financiare	Të dhënat financiare të azhuruara janë në dispozicion të menaxhmentit
Veprimet e planifikuara	
4.1.1	Themelimi i Task Forcës përgjegjëse për transformim digjital: Task Forca do të jetë përgjegjëse për zhvillimin dhe implementimin e strategjisë digjitale.
4.1.2	Përmirësimi i proceseve administrative duke implementuar teknologjitë siç janë: nënshkrimet digjitale, pagesat online
4.1.3	Implementimi i sistemit për menaxhimin e dokumenteve brenda UP-së
4.1.4	Zhvillimi i doracakeve dhe trajnimi i stafit në përdorimin e funksioneve të reja digjitale.
4.1.5	Ristrukturimi i Departamentit të IT-së sipas strategjisë digjitale të universitetit.

Objektivi strategjik 4.2. Digjitalizimi i shërbimeve mësimore brenda universitetit

Arritja e këtij objektivi do të bëhet përmes veprimeve konkrete sikurse trajnimet për të prodhuar dhe aplikuar materiale digjitale për mësimdhënie, rritja e lëndëve që përdorin materiale digjitale për mësimdhënie, investimi në pajisje digjitale, shtimi i sallave të pajisura me pajisje të reja digjitale dhe mbështetja teknike për TI brenda universitetit.

Objektivi Strategjik Nr. 4 – Digjitalizimi dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike	
Objektivi specifik 4.2: Digjitalizimi i shërbimeve mësimore brenda universitetit	
Treguesit	Vlera e synuar 2025
Trajnime për të prodhuar dhe aplikuar materiale digjitale për mësimdhënie	3 trajnime në vit
Numri i lëndëve që përdorin materiale digjitale për mësimdhënie	100% rritje nga numri aktual
Investimi në pajisje digjitale	Rritja e buxhetit për to
Sallat e pajisura me pajisje të reja digjitale	10 salla më shumë
Mbështetje teknike brenda universitetit	Të paktën një person me orar të plotë për tri fakultetet
Veprimet e planifikuara	
4.2.1	Zhvillimi i planit të punës për secilën njësi akademike/lëndë për adaptim sipas standardit digjital për mësim.
4.2.2	Integrimi i procesit të vlerësimit të cilësisë/efektivitetit të lëndëve/programeve sipas të dhënave të përzgjedhura për vlerësimin e lëndës/programit
4.2.3	Zhvillimi i materialeve mësimore digjitale për secilën lëndë
4.2.4	Zhvillimi i mëturjeshëm i moduleve për menaxhimin e mësimit ashtu që relacioni student - profesor të jetë plotësisht digjital.
4.2.5	Zhvillimi dhe implementimi i standardit digjital për mësim, i cili përcakton nivelin obligator të integrimit të teknologjive në klasa, zhvillimin e programeve dhe përmbajtjes online dhe përdorimit të teknologjive për mësim.

Objektivi specifik 4.3. Përmirësimi i teknologjisë së informimit dhe komunikimit brenda sallave mësimore

Ky objektivi nënkupton përmirësimin e rrjetit në gjithë universitetin, duke implementuar infrastrukturën e re, e cila ofron cilësi të rrjetit sipas standardeve më të larta teknologjike për nevojat e universitetit. Po ashtu kërkohet përmirësimi i standardeve të sigurisë si dhe privatësisë së të dhënave. Objektivi parasheh edhe pajisjen e sallave me kamera dhe zërim, pajisjen e sallave të takimeve me teknologji të komunikimit si dhe trajnimin e stafit për përdorim të teknologjisë moderne.

Objektivi Strategjik Nr. 4 – Digjitalizimi dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike	
Objektivi specifik 4.3: Përmirësimi i teknologjisë së informimit dhe komunikimit brenda sallave mësimore	
Treguesit	Vlera e synuar 2025
Qasje me kamerë në salla	Të paktën 20 salla në dispozicion
Qasje në zërim në salla	Të paktën 20 salla në dispozicion
Pajisje moderne të TI-së për stafin	Të paktën 10 laptopë, 5 iPadë, 5 dëgjuese në dispozicion për huazim të përkohshëm 1-2 javë.
Salla takimesh me pajisje moderne të TI-së	Të paktën dy salla për përdorim të përgjithshëm
Trajnimit të stafit për përdorim të TI-së	Të paktën dy trajnime në semestër
Veprimet e planifikuara	
4.3.1	Përmirësimi i rrjetit në gjithë universitetin, duke implementuar infrastrukturën e re, e cila ofron cilësi të rrjetit sipas standardeve më të larta teknologjike për nevojat e universitetit
4.3.2	Përmirësimi i standardeve të sigurisë si dhe privatësisë së të dhënave
4.3.3	Implementimi i plotë i sistemit elektronik për evidentimin e vijueshmërisë në punë dhe funksione të stafit akademik dhe administrativ;

Objektivi Strategjik Nr. 4 – Digjitalizimi dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike	
Objektivi specifik 4.3: Përmirësimi i teknologjisë së informimit dhe komunikimit brenda sallave mësimore	
4.3.4	Përmirësimi i proceseve kërkimore duke përmirësuar infrastrukturën teknologjike për kërkim: vegla për analizën e të dhënave, inteligjencë artificiale dhe të ngjashme
4.3.5	Zhvillimi i kompetencës digjitale përmes zhvillimit të doracakeve dhe trajnimit.

Objektivi specifik 4.4. Zhvillimi i njohurive digjitale të stafit dhe studentëve

Ky objektivi ka për synim rritjen e numrit të pajisjeve të TI-së për studentët dhe punën në grupe, mundësimin e ligjëratave online, mundësinë e dorëzimit të detyrave dhe punimeve online, përdorimin e sistemit antiplagjiat, ruajtjen digjitale të punimeve dhe detyrave si dhe trajnimin e vazhdueshëm të stafit dhe të studentëve për zhvillimin e njohurive të tyre digjitale.

Objektivi Strategjik Nr. 4 – Digjitalizimi dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike	
Objektivi specifik 4.4: Zhvillimi i njohurive digjitale të stafit dhe studentëve	
Treguesit	Vlera e synuar 2025
Pajisje të TI në dispozicion për student dhe punë në grupe	Rritja e numrit të pajisjeve
Ligjerata online	Të paktën 15% të ligjeratave studentët mund t'i ndjekin online
Studentët dorëzojnë detyrat dhe punimet online	Të paktën 40% e detyrave dorëzohen online
Sistemi anti-plagjiat	Sistemi anti-plagjiat përdoret 100% për punimet e diplomës dhe 25% për detyrat
Ruajtja digjitale	Përdorimi i i-cloud për ruajtje
Trajnime për stafin dhe studentët përdorimin e pajisjeve digjitale	Dy herë në semestër për grupe të ndryshme

Objektivi Strategjik Nr. 4 – Digjitalizimi dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike

Objektivi specifik 4.4: Zhvillimi i njohurive digjitale të stafit dhe studentëve

Veprimet e planifikuara

4.4.1	Ndërtimi i objekteve dhe hapësirave kulturore, të cilat do të ndihmojnë në socializimin dhe integrimin e studentëve, motivimin e nëpunësve dhe rritjen e komunitetit të kampusit.
4.4.2	Ridizajnimi hapësirave dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike të bibliotekave me qëllim të krijimit të një ambienti më të ngrohtë (rinovimi, lysterja, riorganizimi) dhe bashkëkohor.
4.4.3	Përmirësimi i infrastrukturës dhe modernizimit të pajisjeve të laboratorëve, me qëllim të krijimit dhe ofrimit të qasjes më të madhe studentëve dhe personelit në veprimtarinë akademike dhe kërkimet shkencore.

Objektivi specifik 4.5. Azhurnimi i politikave dhe proceseve për digjitalizim

Ndër veprimet që parashihen me këtë objektiv janë investimi në rregullimin e hapësirave të jashtme në kampusin universitar, me qëllim të krijimit të një ambienti miqësor, të sigurt dhe të frekuentueshëm për komunitetin në përgjithësi në cilëndo periudhë kohore; krijimin e qasjes së plotë të studentëve me nevoja të veçanta në infrastrukturë fizike, si dhe shenjëzimin drejtues/orientues në të gjithë kampusin universitar (brenda dhe jashtë). Në aspektin e digjitalizimit, ky objektiv synon të promovojë digjitalizimin përmes punësimit dhe emërimit të shefit të digjitalizimit dhe thjeshtëzimit të politikave dhe proceseve që ndërlidhen me digjitalizimin.

Objektivi Strategjik Nr. 4 – Digjitalizimi dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike**Objektivi specifik 4.5: Azhurnimi i politikave dhe proceseve për digjitalizim**

Treguesit	Vlera e synuar 2025
Promovimi i digjitalizimit	Punësimi apo emërimi i shefit të digjitalizimit
Politikat dhe proceset	Politikat dhe proceset janë thjeshtëzuar
Trajnime për digjitalizim	Rritja e numrit të trajnimeve
Veprimet e planifikuara	
4.5.1	Investimi në rregullimin e hapësirave të jashtme në kampusin universitar, me qëllim të krijimit të një ambienti miqësor, të sigurt dhe të frekuentueshëm për komunitetin në përgjithësi, në cilëndo periudhë kohore.
4.5.2	Krijimi i qasjes së plotë të studentëve me nevoja të veçanta në infrastrukturë fizike
4.5.3	Shenjëzimi drejtues/orientues në të gjithë kampusin universitar (brenda dhe jashtë)
4.5.4	Hapja e kafeneve për studentë brenda kampusit universitar, në mjediset e të cilave studentët dhe personeli do ta kenë të mundur ndryshimin e rutinës dhe mjedisit të punës

Objektivi strategjik 5: Fuqizimi i qeverisjes, integritetit dhe financimit

Objektivi i pestë i strategjisë synon fuqizimin e qeverisjes, integritetit dhe financimit. Kjo synohet të arrihet përmes rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, promovimit të integritetit akademik, financimit të qëndrueshëm dhe menaxhimit dhe komercializimit të pronës intelektuale.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 5	Fuqizimi i qeverisjes, integritetit dhe financimit
Objektivi specifik	5.1. Fuqizimi i strukturës organizative dhe ngritja e transparencës dhe llogaridhënies
Objektivi specifik	5.2. Promovimi i integritetit akademik
Objektivi specifik	5.3. Sigurimi i një financimi të qëndrueshëm dhe rritja e transparencës financiare
Objektivi specifik	5.4. Menaxhimi efektiv i pronës
Objektivi specifik	5.5. Menaxhimi dhe komercializimi i pronësisë intelektuale

Objektivi specifik 5.1. Fuqizimi i strukturës organizative dhe ngritja e transparencës dhe llogaridhënies

Ky objektivi synon të rrisë numrin e takimeve të stafit nëpër departamente. Ndër treguesit matës të këtij objektivi janë edhe nxjerrja e planeve për zhvillim individual, largimi i pengesave administrative dhe fuqizimi i lidershit në menaxhim.

Objektivi Strategjik Nr. 5 – Fuqizimi i qeverisjes, integritetit dhe financimit	
Objektivi specifik 5.1: Fuqizimi i strukturës organizative dhe ngritja e transparencës dhe llogaridhënies	
Treguesit	Vlera e synuar 2025
Takime të stafit dhe forumet	Rritja e numrit të takimeve nëpër departamente për vit
Plane për zhvillimin individual	Rritja e stafit që ka ndjekur trajnimet
Mundësi për trajnime	Rritja e stafit që ka ndjekur trajnimet
Fuqizimi i menaxhmentit	Parimet bazë për fuqizimin e lidershit në menaxhim
Pengesat administrative	Largimi i pengesave administrative

Objektivi Strategjik Nr. 5 – Fuqizimi i qeverisjes, integritetit dhe financimit

Objektivi specifik 5.1: Fuqizimi i strukturës organizative dhe ngritja e transparencës dhe llogaridhënies

Veprimet e planifikuara

5.1.1	Zhvillimi dhe implementimi i një procesi të standardizuar të performancës për stafin menaxherial dhe administrativ, përfshirë indikatorët e performancës dhe kriteret e vlerësimit.
5.1.2	Zhvillimi i vlerësimeve të rregullta të performancës (çdo një vit ose çdo dy vjet) për t'u siguruar që stafi i përmbush standardet më të larta të profesionalizmit dhe kompetencës.
5.1.3	Ofrimi i informatave kthyes (feedback) dhe krijimi i planeve individuale të zhvillimit bazuar në rezultatet e vlerësimit, përfshirë trajnimin, mentorimin dhe burimet tjera për të adresuar çfarëdo nevojë të identifikuar për përmirësim.
5.1.4	Vendosja e kanaleve të rregullta të komunikimit siç janë takimet dhe forumet, ku stafi akademik, administrativ dhe studentët mund të diskutojnë dhe të kontribuojnë në çështjet institucionale.
5.1.5	Inkurajimi i ekipeve ndërfunksionale përmes krijimit të grupeve të punës ose task forcës, për të adresuar çështjet dhe/ose projektet specifike që përfshijnë aktorë të ndryshëm nga të gjitha disiplinat e Universitetit të Prishtinës. Përveç kësaj, caktimi i një ekipi përgjegjës për mbledhjen e informatave relevante (përfshirë statistikën) nga njësitë akademike dhe strukturat e universitetit dhe publikimi i raportit në faqen zyrtare të universitetit dhe shpërndarja te palët e interesit përmes buletineve me email, rrjeteve sociale dhe komunikatave për shtyp.

Objektivi specifik 5.2. Promovimi i integritetit akademik

Ky objektivi synon ta rrisë efikasitetin e sistemit të raportimit dhe monitorimit, duke zvogëluar kohën për zgjidhjen e incidenteve apo shkeljeve akademike, duke lehtësuar qasjen në përdorimin e sistemit të raportimit dhe njoftimin e stafit të ri me rregullat e universitetit. Ndër veprimet konkrete parashihen edhe krijimi i kampanjave të targetuara për të ngritur vetëdijësimin dhe parandaluar rastet specifike të sjelljes së pahijshme akademike (plagjiaturën, ngacmimin seksual dhe ngacmimin tjetër apo mashtrimin).

Objektivi Strategjik Nr. 5 – Fuqizimi i qeverisjes, integritetit dhe financimit

Objektivi specifik 5.2: Promovimi i integritetit akademik

Treguesit	Vlera e synuar 2025
Efikasiteti i sistemit të raportimit dhe monitorimit	Koha për zgjidhjen e incidenteve apo shkeljeve akademike brenda dy jave
Efikasiteti i qasjes dhe përdorimit të sistemit të raportimit.	Komentet/vlerësimet e përdoruesve.
Punonjësit e rinj njoftohen me rregullat dhe parimet	Për 95% të stafit të ri njoftohen me rregullat e nevojshme
Trajnime të domosdoshme	Rritja e numrit të stafit dhe studentëve që kanë ndjekur trajnimet e domosdoshme.
Veprimet e planifikuara	
5.2.1	Implementimi i një sistemi efikas të përcjelljes dhe raportimit për të monitoruar dhe analizuar rastet e sjelljes së pahijshme akademike (një platformë lehtë të përdorueshme dhe konfidenciale të raportimit) dhe zhvillimi dhe promovimi i udhëzuesve të qartë për masat mbrojtëse për sinjalizuesit.
5.2.2	Krijimi i kampanjave të targetuara për të ngritur vetëdijesimin dhe parandaluar rastet specifike të sjelljes së pahijshme akademike (plagjiaturën, ngacmimin seksual dhe ngacmimin tjetër, mashtrimin etj.).
5.2.3	Krijimi dhe shpërndarja e anketimeve vjetore për të vlerësuar njohuritë, përputhshmërinë dhe klimën etike brenda universitetit.
5.2.4	Ofrimi i trajnimeve të rregullta të detyrueshme për stafin akademik, administrativ dhe studentët, përfshirë zhvillimin e burimeve atraktive edukuese online, siç janë kurset dhe udhëzimet online për të promovuar sjelljen etike.
5.2.5	Fuqizimi i mëtutjeshëm i Këshillit të Etikës për të hetuar dhe zgjidhur rastet e sjelljes së pahijshme akademike dhe krijimi i një ekipi të dedikuar për t'i asistuar sinjalizuesit gjatë tërë procesit të raportimit.

Objektivi specifik 5.3. Sigurimi i një financimi të qëndrueshëm dhe rritja e transparencës financiare

Përmes këtij objektivi synohet rritja e fondeve publike për universitetin, rritja e të hyrave nga sektori privat, si dhe rritja e të hyrave të tjera sikurse nga licencimet dhe trajnimet. Veprimet e parapara nën këtë objektiv janë zhvillimi i një strategjie gjithëpërfshirëse të ngritjes së fondeve për të identifikuar burimet e mundshme të financimit, siç janë grantet, donacionet, sponsorizimet dhe entitetet publike dhe private dhe krijimi i një ekipi përgjegjës për hulumtimin dhe sigurimin e mundësive të reja për financimin e universitetit.

Objektivi Strategjik Nr. 5 – Fuqizimi i qeverisjes, integritetit dhe financimit	
Objektivi specifik 5.3: Sigurimi i një financimi të qëndrueshëm dhe rritja e transparencës financiare	
Treguesit	Vlera e synuar 2025
Rritja e fondeve publike.	Rritja e të hyrave në euro
Rritja e të hyrave nga sektori privat.	Rritja e të hyrave në euro
Rritja e të hyrave nga licencimet.	Rritja e të hyrave në euro
Të hyrat e gjeneruara nga trajnimet dhe kurset online.	Rritja e të hyrave në euro
Të hyrat e mbledhura nga prodhimet tjera të universitetit.	Rritja e të hyrave në euro
Veprimet e planifikuara	
5.3.1	Zhvillimi i një strategjie gjithëpërfshirëse të ngritjes së fondeve për të identifikuar burimet e mundshme të financimit siç janë grantet, donacionet, sponsorizimet dhe entitetet publike dhe private.
5.3.2	Krijimi i një ekipi përgjegjës për hulumtimin dhe sigurimin e mundësive të reja për financimin e universitetit.

Objektivi Strategjik Nr. 5 – Fuqizimi i qeverisjes, integritetit dhe financimit

Objektivi specifik 5.3: Sigurimi i një financimi të qëndrueshëm dhe rritja e transparencës financiare

5.3.3	Lidhja e partneriteteve me industrinë dhe sektorin privat për kërkime të përbashkëta, projekte inovative dhe iniciativa tjera, të cilat gjenerojnë të hyra për universitetin.
5.3.4	Zhvillimi dhe ofrimi i kurseve, programeve të trajnimit dhe produkteve tjera edukative online për licencim dhe shitje për të gjeneruar të hyra shtesë për universitetin.
5.3.5	Lansimi i një programi të tregtisë për universitetin, ku parashihet shitja e veshjeve, aksesorëve dhe produkteve tjera që përmbajnë markat dhe logot e universitetit, për të gjeneruar të ardhura dhe për të promovuar brendin e universitetit.

Objektivi specifik 5.4. Menaxhimi efektiv i pronës

Veprimet që parashihet të ndërmerren brenda këtij objekti janë rishikimi dhe azhurnimi i saktësisë së të dhënave të menaxhimit të aseteve, përfshirë verifikimin dhe përditësimin e të dhënave relevante dhe pronësinë e aseteve të paluajtshme të universitetit; krijimin e një platforme digjitale lehtë të përdorueshme për menaxhimin e aseteve të paluajtshme të universitetit dhe rritjen e numrit të kontesteve pronësore të zgjidhura që ndërlidhen me pronën e UP-së.

Objektivi Strategjik Nr. 5 – Fuqizimi i qeverisjes, integritetit dhe financimit

Objektivi specifik 5.4: Menaxhimi efektiv i pronës

Treguesit	Vlera e synuar 2025
% e pronës së re	% e të dhënave mbi pronën e re në sistemin për menaxhimin e pronës
Numri i kontesteve pronësore të zgjidhura që ndërlidhen me pronën e UP-së	30% rritje

Objektivi Strategjik Nr. 5 – Fuqizimi i qeverisjes, integritetit dhe financimit

Objektivi specifik 5.4: Menaxhimi efektiv i pronës

Veprimet e planifikuara

5.4.1	Rishikimi dhe azhurnimi i saktësisë së të dhënave të menaxhimit të aseteve, përfshirë verifikimin dhe përditësimin e të dhënave relevante dhe pronësinë e aseteve të paluajtshme të universitetit.
5.4.2	Krijimi i një platforme digjitale lehtë të përdorueshme për menaxhimin e aseteve të paluajtshme të universitetit.
5.4.3	Rekrutimi dhe trajnimi i stafit për të menaxhuar, mirëmbajtje dhe përditësuar sistemin digjital të menaxhimit të pasurisë së paluajtshme.
5.4.4	Bashkëpunimi me autoritetet relevante dhe palët e interesit për ndarje dhe shkëmbim të informacionit dhe zgjidhjen e kontesteve në lidhje me pronën e paluajtshme të universitetit.
5.4.5	Hartimi dhe miratimi i udhëzimeve të qarta në lidhje me menaxhimin e pasurisë së paluajtshme të universitetit.

Objektivi specifik 5.5. Menaxhimi dhe komercializimi i pronësisë intelektuale

Ky objektivi synon themelimin dhe menaxhimin e Zyrës për Pronësi Intelektuale brenda universitetit me personel të trajnuar për zhvillimin e politikave. Po ashtu synohet edhe rishikimi i rregullt dhe vlerësimi i rezultateve kërkimore për të identifikuar asetet e mundshme të pronësisë intelektuale si dhe mbrojtjen e duhur të aseteve të pronësisë intelektuale, përfshirë regjistrimet e patentave, markave tregtare, mbrojtjen me të drejtën e autorit etj. Ofrimi i trajnimeve dhe burimeve për komunitetin e universitetit mbi mbrojtjen dhe menaxhimin e pronësisë intelektuale është një ndër veprimet tjera po ashtu.

Objektivi Strategjik Nr. 5 – Fuqizimi i qeverisjes, integritetit dhe financimit**Objektivi specifik 5.5: Menaxhimi dhe komercializimi i pronësisë intelektuale**

Treguesit	Vlera e synuar 2025
Një sistem i duhur është në funksion	Zyra për pronën intelektuale është themeluar dhe është funksionale
Numri i personelit është trajnuar dhe angazhuar	5 persona janë trajnuar si duhet
Numri i aplikimeve dhe regjistrimeve të brendeve, patentave dhe formave të tjera të pronës intelektuale.	10 për tri vite
% e të hyrave të mbledhura nga licencimi dhe komercializimi i pronës intelektuale	50% rritje për 3 vjet
Veprimet e planifikuara	
5.5.1	Themelimi dhe menaxhimi i Zyrës për Pronësi Intelektuale brenda universitetit me personel të trajnuar për zhvillimin e politikave, rishikimin e rregullt dhe vlerësimin e rezultateve kërkimore për të identifikuar asetet e mundshme të pronësisë intelektuale.
5.5.2	Mbrojtja e duhur e aseteve të pronësisë intelektuale, përfshirë regjistrimet e patentave, markave tregtare, mbrojtjen me të drejtën e autorit etj., dhe ofrimi i trajnimeve dhe burimeve për komunitetin e universitetit mbi mbrojtjen dhe menaxhimin e pronësisë intelektuale.
5.5.3	Komercializimi i aseteve të pronësisë intelektuale përmes partneriteteve me industri, zyra për transfer të teknologjisë, inkubatorë biznesi dhe zhvillimi i strategjive të licencimit për kurse dhe trajnimet online dhe produktet tjera të universitetit.
5.5.4	Zhvillimi dhe shitja e produkteve që përmbajnë logon e universitetit sipas strategjisë gjithëpërfshirëse për ngritjen e fondeve të universitetit.
5.5.5	Vlerësimi i rregullt i performancës së portfolios të pronësisë intelektuale, përfshirë të hyrat e gjeneruara nga licencimi dhe komercializimi dhe identifikimi i fushave për përmirësim.

6. ZBATIMI, MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Monitorimi dhe vlerësimi janë faktorë themelorë të zbatimit të një strategjie dhe synojnë matjen e progresit të arritur. Këshilli Drejtues i UP-së emëron një komision për monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të kësaj strategjie, sipas dinamikës së paraparë për Planin e Veprimit. Komisioni për monitorimin dhe vlerësimin e implementimit të strategjisë, në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha strukturat relevante të UP-së, do të monitorojë rregullisht zbatimin e Planit të Veprimit të kësaj strategjie dhe në etapa të caktuara të raportojë. Këshilli Drejtues i UP-së do të jetë përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e kësaj strategjie. Të dhënat që njësitë akademike dhe zyrat përkatëse do të dorëzojnë në komision për monitorim dhe vlerësim duhet të përfshijnë: aktivitetet e realizuara dhe progresin, efektet, ndikimet, vështirësitë, mësimet e nxjerra dhe rekomandimet. Me qëllim të vlerësimin të arritjes së treguesve, strategjia parasheh raportimin vjetor, i cili do të ofrojë një pasqyrë me të dhëna të hollësishme mbi arritjen e objektivave strategjike, objektivave specifike dhe veprimeve të planifikuara.

Zyrtarët përgjegjës do të marrin të dhëna edhe nga donatorët. Për të siguruar monitorimin e duhur të Planit të Veprimit janë përcaktuar treguesit për monitorimin e zbatimit të strategjisë. Këta tregues do të mundësojnë monitorimin e progresit, duke vënë në dukje nivelin e arritjes së objektivave dhe realizimin e qëllimeve të kësaj strategjie. Kjo strategji është një dokument aktiv dhe do të rishikohet e do të plotësohet në baza vjetore. Monitorimi dhe vlerësimi i qëndrueshëm i kësaj strategjie përmes Planit të Veprimit iu siguron zbatuesve të saj një pasqyrë, e cila ua mundëson të veprojnë me kohë dhe në përputhje me nevojat dhe sfidat, me të cilat përballet aktualisht sektori i arsimit të lartë, por edhe në të ardhmen. Plani i Veprimit i kësaj strategjie është ndërtuar në një strukturë tabelare, progresi i të cilit do të monitorohet rregullisht në takimet e rregullta të udhëhequra nga Komisioni për Monitorim dhe Vlerësim. Në fund të zbatimit të strategjisë do të bëhet një vlerësim i përgjithshëm për të kontrolluar deri në çfarë mase kjo strategji ka ndikuar në fuqizimin e universitetit, duke i konsideruar si bazë dokumentet relevante nga MASHTI. Vlerësimi përfundimtar i strategjisë do të bëhet në fund të vitit 2025. .

7. NDIKIMI BUXHETOR I STRATEGJISË

Planifikimi strategjik dhe zbatimi i strategjisë për Universitetin e Prishtinës kanë një ndikim të rëndësishëm në aspektin buxhetor dhe kërkojnë mobilizimin e burimeve financiare për të realizuar hapat e nevojshëm drejt qëllimeve të strategjisë. Përderisa shumica e iniciativave mund të jenë të realizueshme me buxhetin ekzistues, disa prej tyre mund të kërkojnë mbështetje financiare nga donatorët potencialë.

Në përgjithësi, implementimi i planit strategjik mund të sjellë përfitime në aspektin buxhetor në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të ndërmjetësuar. Këto përfitime mund të përfshijnë:

Rritjen e të ardhurave, nëpërmjet rritjes së numrit të studentëve, të zhvillojë programe të reja studimore ose të përmirësojë oferta ekzistuese. Në rritje të të ardhurave të universitetit do të kontribuojnë dhe rritja e numrit të hulumtuesve dhe fuqizimi i instituteve.

Partneritete dhe donacione, ku në bazë të këtij plani strategjik, UP-ja përfshin hapa për të siguruar partneritete strategjike me organizata, biznese apo universitete të tjera, si dhe për të zhvilluar marrëdhënie të mira me komunitetin dhe donatorët potencialë. Këto partneritete dhe donacione mund të ndihmojnë në financimin e projekteve specifike apo në sigurimin e burimeve për harkun afatgjatë.

Efikasiteti i resurseve, nëpërmjet rritjes së efikasitetit të operacioneve universitare, siç janë përmirësimi i proceseve administrative, konsolidimi i strukturave organizative dhe përdorimi i teknologjisë për të rritur efikasitetin. Kjo mund të çojë në ulje të kostove dhe përdorimin më të mirë të burimeve ekzistuese.

Megjithatë, është e rëndësishme të kuptohet se ndërhyrjet buxhetore për zbatimin e strategjisë së universitetit varen nga situata specifike financiare dhe disponueshmëria e burimeve. UP-ja duhet të zhvillojë një plan financiar të qëndrueshëm dhe të konsiderojë burimet potenciale të financimit për të siguruar suksesin e implementimit të strategjisë.

Për më tepër, bashkëpunimi me donatorët, ndërmarrjet, qeverinë dhe partnerët e tjerët është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Universiteti i Prishtinës ka shpresë se komuniteti i donatorëve do të vazhdojë të mbështesë UP-në nëpërmjet kontributit financiar për këto iniciativa, ashtu siç kanë bërë në projektet e mëparshme. Kjo mbështetje shtesë do të ndihmojë në realizimin e planeve dhe në forcimin e zhvillimeve pozitive në UP, duke arritur qëllimet e përbashkëta për një arsim cilësor dhe një rritje të punësimit të studentëve të UP-së. Në këtë mënyrë, studentët e diplomuar do të kenë njohuri, aftësi dhe kompetenca që i kërkon tregu i punës.

